



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJESHJELLES KANALIZIME ELBASAN

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më 03.12.2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

**Për: operatorin ekonomik “Instituti Dekliada - ALB” sh.p.k**

**Nipt : K71606006A**

**Adresa: rruga "Milto Tutulani", ndertesa 4, hyrja 10, apartamenti 6, Njesia Bashkiake nr.5,TIRANE**

Procedura e prokurimit:**Kerkese per propozim (SHERBIM)**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF – 40035-10-17-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti 2 : Supervizim i “Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengel-Samurr-Godolesh,(për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve”.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): **Buletini i Njoftimeve Publike [21.10.2019] [42]**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara: jane paraqitur për të marrë pjesë **5 (pesë) operator ekonomik** me ofertat ekonomike sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emri i Operatorit Ekonomik ofertues	NIPT i Operatorit Ekonomik	Vlera pa tvsh
1	“6D – Plan” shpk	L62717405 H	1 146 000 leke
2	Bashkimi i operatoreve “Arena MK” shpk dhe “HE & SK” shpk	L67619801Q L19008502B	1 033 885,13 leke
3	“Instituti Dekliada - ALB” shpk	K71606006A	1 033 885,12 leke
4	Bashkimi i operatoreve “MCE” shpk dhe “CIVIL CONS” shpk	L72203065K L19008502B	1 033 889,34 leke
5	“NET Group” shpk	L81315015O	1 033 885,13 leke

➤ Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur, ofertuesi ekonomik “6D – Plan” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë administrativo - ligjor sipas kriterëve të pranimit/kualifikimit të përcaktuara nga njësia e prokurimit. Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1 146 000** (një milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë (pa tvsh).

Kriteret të cilat nuk plotëson janë:

- *Sipas pikës 2.2.3 të kriterit të veçantë të pranimit për stafin teknik, OE nuk ka paraqitur librezat e punës.*
- *Sipas pikës 2.2.3/c të shtojcës 1 të kriterit të veçantë të pranimit për stafin teknik nuk e plotëson, se nuk ka paraqitur: -1 (një) punonjës të pajisur me certifikat “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, - 1 (një) punonjës, i cili të disponoj certifikat si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.*
- *Sipas pikës 3 të kriterit të veçantë të kualifikimit për Liçencën Profesionale të Shoqërisë, OE nuk ka kategorine NS-16 (Ndertim i impianteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij).*

➤ Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur, bashkimi i operatorëve “Arena MK” sh.p.k me “HE & SK 11” sh.p.k, ka paraqitur dokumentacion të saktë administrativo - ligjor sipas kriterëve të pranimit/kualifikimit të përcaktuara nga njësia e prokurimit. Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1 033 885,13** (një milion e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë presje trembëdhjetë) lekë (pa tvsh).

➤ Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur, ofertuesi ekonomik “Instituti Dekliada - ALB” sh.p.k, ka paraqitur dokumentacion të saktë administrativo - ligjor sipas kriterëve të pranimit/kualifikimit të përcaktuara nga njësia e prokurimit. Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1 033 885,12** (një milion e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë presje dymbëdhjetë) lekë (pa tvsh).

➤ Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur, bashkimi i operatorëve “MCE” sh.p.k me Nipt L72203065K me “CIVIL CONS” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë administrativo - ligjor sipas kriterëve të pranimit/kualifikimit të përcaktuara nga njësia e prokurimit. Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **1 033 889,34** (një milion e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë presje tridhjetë e katër) lekë (pa tvsh) Kriteret të cilat nuk plotëson janë:

- Sipas pikës 1/c të kriterit e përgjithshëm të pranimit/kualifikimit, OE nuk ka paraqitur deklaratën, që nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP.
  - Sipas pikës 1/ç të kriterit e përgjithshëm të pranimit/kualifikimit, OE nuk ka paraqitur deklaratën, që nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, ofertuesi ekonomik “NET Group” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë administrativo - ligjor sipas kriterëve të pranimit/kualifikimit të përcaktuara nga njësia prokurimit. Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **506 051,26** (pesëqind e gjashtë mijë e pesëdhjetë e një presje njëzetë e gjashtë) lekë (pa tvsh).

Kriteret të cilat nuk plotëson janë:

- Sipas pikës 2.2.3/c të shtojcës 1 të kriterit të veçantë të pranimit për stafin teknik nuk e plotëson, se nuk ka paraqitur: -1 (një) punonjës të pajisur me certifikat “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.
- Sipas pikës 3 të kriterit të veçantë të kualifikimit për Liçencën Profesionale të Shoqërisë, OE nuk ka kategorinë NS-16 (Ndërtim i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij).

Komisioni i vlerësimit të ofertave më datë 19.11.2019 konkludoi se OE “**6D – Plan**” sh.p.k, BOE “**MCE**” sh.p.k & “**CIVIL CONS**” sh.p.k dhe OE “**NET Group**” sh.p.k skualifikohen për mungesë të dokumentacionit të pranimit/kualifikimit të përcaktuara nga Njësia e Prokurimit, që mungesat e tyre janë paraqitur më sipër për secilin operator dhe pranon për dokumentacion të plotë BOE “**Arena MK**” sh.p.k me “**HE & SK 11**” sh.p.k dhe OE “**Instituti Dekliada - ALB**” sh.p.k

Komisioni i vlerësimit të ofertave pranon për dokumentacion të plotë BOE “**Arena MK**” sh.p.k me “**HE & SK 11**” sh.p.k dhe OE “**Instituti Dekliada - ALB**” sh.p.k.

Bazuar ne Kriterin e Vlerësimit “**Çmimi më i ulët**”, i përcaktuar ne dokumentat e tenderit, ne kushtet kur kane ngelur dy oferta te vlefshme, KVO ben kete renditje:

Nr.	Emri i Operatorit Ekonomik ofertues	NIPT i Operatorit Ekonomik	Vlera e korigjuar
	Bashkimi i operatoreve “Arena MK” shpk dhe “HE & SK” shpk	L67619801Q L19008502B	1 033 885,13 leke (pa gabime)
	“Instituti Dekliada - ALB” shpk	K71606006A	1 033 885,12 leke (pa gabime)

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik “Instituti Dekliada - ALB” sh.p.k** me vlerë të ofertuar prej **1 033 885,12** (një milion e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë presje dymbëdhjetë) lekë (pa tvsh) e me vlerë kontrate prej **1 240 662,15** (një milion e dyqind e dyzet mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy presje pesëmbëdhjetë) lekë (me tvsh) dhe pa gabime aritmetike ,oferta është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë AK :*Sha Ujesjelles Kanalizime Elbasan* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese)ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19 .11 .2019.

Ankesa: ka ose jo\_: NUK KA PATUR ANKESA.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**ADMINISTRATORI**  
**LUAN DERVISHI**